

Dëshironi të bëheni më konkurrues? *Ja se si.*

Me financim nga Luksemburgu, ne ndihmuam Europa Construction, një kompani përpunim metali në Shqipëri, për të zhvilluar një plan të ri strategjik për një të ardhme më të shkëlqyer.



Kompani përpunim metali, Shqipëri

Ne ndihmuam Europa Construction, një kompani përpunim metali në Shqipërinë e mesme, për të zhvilluar planin e vet strategjik për të ardhmen. Brenda një viti pas mbylljes së projektit, Europa Construction nënshkroi një kontratë të suksesshme me Alstom, kompani Franceze lider, e cila kryen punimet inxhinierike në Hidrocentralin e Banjës, në lumin Devoll. Kjo ndihmoi kompaninë për t'u zhvilluar dhe rritur xhiron vjetore me 250%.

Ky biznes familjar nisi aktivitetin në 1995 dhe është i vendosur në periferi të Elbasanit, një nga qytetet më të mëdha të Shqipërisë. Dy vëllezër, Vangjel dhe Thanas Rula, krijuan Europa Construction, e cila prodhon konstruksione metalike të cilat përdoren për tunele, diga, arena sportive, kinema dhe objekte industriale.

Në mënyrë që t'i përgjigjeshin kërkesës në rritje për produktet e tyre dhe të përfshiheshin në zbatimin e projekteve me të mëdha, nevojiteshin investime të mëtejshme, për të rritur kapacitetin prodhues të kompanisë.

Kompania kishte nevojë për të zhvilluar një plan të ri biznesi dhe strategjik për të ardhmen, i cili të përfshinte



Me ndihmën e BERZH, Europa Construction është duke përmirësuar infrastrukturën e vendit

investimin që duhej të ndërmerrej për zgjerimin e sipërfaqes së prodhimit dhe blerjen e teknologjisë së re. Vëllezërit Rula e dinin që një plan strategjik i mirë-strukturuar do t'i ndihmonte ata në planifikimin e të ardhmes dhe të krijonin qasjen e duhur drejt klientëve të synuar.

Ne lidhëm Europa Construction me një konsulent lokal, Naim Çope – RDA Elbasan. Konsulenti:

- Ndërmori një kërkim të plotë tregu
- Zhvilloi një plan të ri biznesi dhe strategjik i cili përbante vlerësimin dhe projeksionet financiare për dy vitet në vijim
- Asistoi gjatë zbatimit të strategjisë së marketingut të kompanisë, e cila përfshinte një identitet të rinovuar dhe përdorimin e instrumentave bashkëkohorë të marketingut

Me një strategji të qartë biznesi, Europa Construction qasi një bankë lokale, e cila financoi pjesërisht investimin e kërkuar, në shumën €450,000. Që atëherë, performanca e kompanisë u përmirësua në mënyrë të ndjeshme nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të suksesshme dhe qasjes së duhur drejt klientëve.

Aktualisht, Europa Construction operon në një sipërfaqe prej 6,000m²; sistemi i prodhimit është më efektiv, siguria për 80 punonjësit e saj është rritur, si dhe kostot e defektet në prodhim janë ulur.

Mbështetja nga BERZH ka qënë shumë e rëndësishme për kompaninë, përmes asistencës së mëparshme për zbatimin dhe çertifikimin sipas standardeve ISO.

“Është një moment shumë i mirë për ne,” tha Ermal Rula, një nga menaxherët e kompanisë. “Çertifikimi ISO dhe plani i biznesit hapën shumë mundësira për ne”.

Xhiro Vjetore
+250%

Punonjës
+66%

Eksporte
+25%

Vlera totale e projektit
€9,800

Kontributi i klientit
€4,900